REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 957, 967, 994/20
Datë/Datum. 03.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilaz Papaj-Ekspert Shqyrtues	*Data e autorizimit të ekspertit 24.11.2020*	*Data e dorëzimit të raportit 02.12.2020*	Nr. i lëndës: *957-967-994/20*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë:17.11.2020,OE"Rexha" Shpk-Prishtinë, datë 18.11.2020,OE "Pe-vla-ku" Shpk-Prishtinë dhe datë 23.11.2020,OE "Raf II" Shpk-Rahovec,kanë parashtruar ankesë me nr: 957-967-994/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE "Fidola" & "Nartel Exin"Shpk,lidhur me aktivitetin e prokurimit"**Tregu i ri i qytetit"** me nr.prokurimi 616-19-9686-5-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)) –"KK Prishtinë".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:Kontratë Publike,**Punë**,vlera e parashikuar e kontratës: **5,524.160.12 €.**

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka një vendim të OSHP-së,PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020 me të cilin është rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "REXHA"SHPK -PRISHTINË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- **Neni 7 i LPP- së**
- **Neni 10 i LPP-së**
- **Neni 27 i LPP-së**
- **Neni 52 i LPP-së**
- **Neni 59 i LPP-së**
- **Neni 60 i LPP-së**
- **Neni 61 i LPP-së**
- **Neni 65 i LPP-së**
- **Neni 72 i LPP-së**

  - Vendimi i OSHP-së.

- Vendmi i juaj për arpovim të kërkeses tonë

Të nderuar po i' rishkrujam kërkesen tonë për ri-shqyrtim pasi që AK në mungesë të stafit adekuat dhe jo-profesinal e pranon se nuk ka mundësi të trajtoj /ndalë padrejtësin dhe diskrimin që na është bërë në këtë AP.

Pas njoftimit për kontratë ne kemi shkarkuar DT dhe kemi plotësuar të gjitha krireret e kërkuara.
Ne po e rishkruajm kërkesen e parë për të ju bërë mbajtur të informuar për veprimet tuaja skendaloze.

Kriter për dhënjen e kontratës ka qenë Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 ☒

	Nënkriteret	Koeficient
1	Cmimi	0,80
2	Mirembajtja	0,20

Periudha garantuese: 10 vite
OE duhet te ofroj:

1. Cmimin per ndertim (i cili ka peshen 80%)
2. Cmimin per mirembajtje te objektit pas ndertimit (i cili ka peshen 20%).

Cmimi i ofertuar per mirembjatje do te perpjestohet dhe do te paguhet ne baza mujore.

Ne me datë 28.05.2020 jemi njoftuar mbi vendimin e AK-së ku OFERTËN tonë e ka eliminuar për arsyet e poshtë shënuara.

"Rexha"shpk,"Arhiko ingO.P" NPN "Euroing"shpk

1. Nga ATK ka dorëzuar qarkullim 2.8mil€(duhet me qenë 6mil. Euro), ndërsa për vitin 2019, ka sjell deklarate nga banka , se ne vitin 2019, ka pas qarkullim në vlerë 2,623,087.32€, , edhe me këtë vlerë nuk e mbulon vlerën e kërkuar të qarkullimit për lider që duhet të jetë 6mil.
2. Nuk ka prezantuar referenca për ndërtim të lartë (nuk ka ofruar dëshmi , për punët e ndërtimit të lartë që duhet të jetë 4.5mil euro)
3. Në paramasë, te objekti 3, poz. Nr. 9, Punët e fasadës , pozicioni 9.1 është përsërit dy herë , gjë që ndryshon nga paramasa e ofertuar

Sa i përket pretendimit të parë është e pa kuptimit kur OE tërekomanduar për kontratë i keni

pranuar një kontratë që ka përfunduar me 31.12.2019 si qarkullim valid dhe nuk e keni pranuar qarkullim e ATK-së tonin për vitin 2016 pasi që LPP thotë së duhet të merren për bazë vlerat 3 vite duke u këthyer 3 vite nga data e njoftimit për kontratë: dhe nese kthehemi 3 vite pas atëhere 31.12.2016 është data e përfudimit të vitit 2016 dhe duhet të merret për bazë. Në këtë rast AK ka përdorur standarte të dyfishta.
Sa i përket pretenditmit të dytë se nuk kemi dorëzuar referenca të ndërtimit të lartë edhe ky pretendim nuk qnëdron pasi që sipasi
Ju në saqrimin e datës: 31.01.2020 keni cekur se
Nuk pranohen eksperienca e punës së renovimeve , por pranohen referencat e ndërtimeve te larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit te nenit 3 paragrafi 1.10te ligjit për nderim NR.04 L-110)

Dhe sipas Ligjit Nr. 04/L – 110 PËR NDËRTIM NENI 3
Thuhet.
1.10. Ndërtimi i ri – ndërtim që kryhet në pjesë të një parcele toke ku nuk ka ndërtim ose që zëvendëson plotësisht ndërtimin ekzistues.
Të gjitha punët kontraktuale që ne kemi këryer deri më sot i takojn kësaj natyre.

Ne kemi preznatuar të gjitha kontratata /referenca që tejkalojn këtë vlerë dhe për këtë jeni edhe ju dëshmitar pasi që edhe kemi kontrata me ju.
Andaj pretendimi juaj është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të 3 sipas LPP përkatësisht nenit 59 pika 3 thuhet

1. Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total. Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

Edhe nëse egzisto një gabim i tillë atëhere vlera që është në këtë pozicion nuk e arrin 2% dhe keni qenë të detyruar të veproni konform këti neni.

Ju nuk keni respektuar kriterin tuaj pasi që kompania jonë ka ofruar çmimin më të lirë të përgjegjëshem dhe jemi me 100% poentim, por standartet e dyfishta që ju keni përdorur neve do i drejtohemi edhe organeve tjera relevante për shkeljet dhe ndikimet që ka pasur në këtë AP.
OE i shpallur fitues ka ofruar lista të kontratave që nuk i përkojn kërkeses tuaj,tek lista e kontratave kontrata nr 4 me titull: Ndërtimi i Spitalit Pediatrik dhe Kirurgjisë Pediatrike, QKUK, Prishtinë.
Për këtë kontratë ky OE ka prezantuar sikur se të ishte me një AK shtetëror dhe në faktë nuk posedon referncë nga vetë AK por nga një kompani që gjoja janë në nënkontraktim, ne jemi në dijeni që lejohënen nënkontraktimet por qdo herë duhet të bëhet në pajtim me AK dhe se a

është e kënaqur me punen e kryer nuk e bënë asnjë kompani private por është dashur të prezantohet referenca nga vetë AK këtë rast QKUK.
Edhe në DT thuhet se:
4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Kontraktuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.
Në këtë rast ju nuk keni vepruar në kundërshtim duke marrë si legjitime një kontratë që vështir të besohet se është legjitime.
Sa i përket antarit tjetër të koncersiumit ai ka prezantuar një listë jo valide pasi që në rubriken e klientit (blerësit) ka prezantuar vetëvetën dhe nuk ka ndonjë referencë të bashëkangjitur dhe se e till kjo list nuk duhet të merret si legjitime.

Lidhur me ISO STANDARTE ju keni kërkuar decitivisht:

3. O.E. duhet te posedoj certifikaten ISO 9001 2015	3. Kopja e Certifikatës te noterizuara
4. O.E. duhet te posedoj certifikaten ISO 14001 2015	4. Kopja e Certifikatës te noterizuara
5. O.E. duhet te posedoj certifikaten OHSAS 18001 2007	5.Kopja e Certifikatës te noterizuara
6. O.E. duhet te posedoj certifikaten ISO 27001 2013	6.Kopja e Certifikatës te noterizuara
7. O.E. duhet te posedoj certifikaten ISO 39001 2012	7. Kopja e Certifikatës te noterizuara
8. O.E. duhet te posedoj certifikaten PAS 99 2012	8.Kopja e Certifikatës te noterizuara

OE nuk ka ofruar të noterizuara dhe ju në Raportin e vlerësimit keni thën se ka ofruar Origjinal por kërkesa juaj ka qenë që të jetë kopje e noterizuar dhe nuk e plotëson këtë kriter për faktin se janë kërkuar të noterizuara.

Ne kemi kërkuar edhe komunikimet që keni bërë me këtë OE por nuk na janë dhënë me pretekstin se ka plotësuar kërkesen për konfincedialitet, por ky veprim është mashtrues nga ana juaj pasi që në ofertën e tyre por as edhe në formularin për tender nuk egziston një kërkes e tillë andaj me këtë verpim nga ana juaj ne do i drejtohemi organeve relevante për mashtrimin që keni bërë ndaj nesh.

Vendimi juaj pas kërkeses:

VENDIM

1.Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga " Rexha SHPK" e dates 02.06.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Tregu i ri i qytetit ", me Nr. të Prok: **616 19 9686 511 ,** kundër Vendimit te AK –së, të datës **28.05.2020.**
2.Autoriteti Kontraktues, vendos qe te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me titull "Tregu i ri i qytetit", me Nr. të Prok: **616 19 9686 511 sipas njoftimit te dates 28.05.2020.**
3.Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 03,04 dhe 05 .06.2020 ka shqyrtuar kërkesën e grupit të OE-ik "Rexha SHPK&"dhe lidhur me pretendimet e të njejtit ka konstatuar si vijon:
-Pretendimi i parë është pjesërisht i bazuar pasi që duke analizuar dëshmitë tuja të dorëzuara nga ATK-ja për vitet 2016,2017 dhe 2018 dhe raportin bankar për vitin 2019 konstatoj se ka ekzistuar mundësia ligjore që të kërkohen sqarime shtesë,por kjo nuk eshte bere per arsye se ju nuk keni plotesuar kriterin per referencat per pune te kerkuara ne FDT e qe do ta sqarojme ne biken vijuese;

-Pretendimi tjetër se Autoriteti Kontraktues ka sqaruar në fazën para hapjes së tenderit se nuk janë të pranueshme referencat për renovime,por vetëm për ndërtimet e reja është i formuluar si duhet,pasi që e verteta është se formulimi ynë ka qenë i tillë dhe në bazë të të njejtit janë trajtuar referencat e të gjithë tenderuesëve e edhe tuajat.Këtu duhet shtuar se po në atë fazë një tenderues ka dorëzuar kerkesë për rishqyrtim me pretendimin se kërkesat tona që ndërlidhen me referencat për ndërtime të larta janë kufizuese dhe se duhet te pranohen edhe referencat për ndërtime të ulta dhe ne në përgjegjen tonë ndaj të njejtit kemi sqaruar në detaje pse janë vendosur ato kritere.Pas pergjgjes tone asnjë OE-ik i interesuar për këtë aktivitet nuk e ka kontestuar kerkesen tone dhe kemi konstatuar se kerkesat tona janë të pranueshme për të gjithë të interesuarit e posaçërisht për OE-ik si ju që kanë marrë pjesë duke dorëzuar ofertat e tyre.Pra është e qartë se referencat e dorëzuara nga ju kryesisht janë referenca të ndërtimit të ulët dhe si të tilla nuk janë në harmoni me kërkesat e FDT-së;
-Pretendimi se gabimi në paramasë(përseritja e një pozicioni) kamund të sqarohet është i bazuar,por ky sqarim nuk është kërkuar pasi qe nuk keni plotësuar kërkesat tona lidhur me referencat e kërkuara;
-Pretendimet tuaja lidhur me referencat e grupit të OE-ik të rekomanduar për dhënje të kontratës ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar dhe ka pranuar sqarimet lidhur me këtë dhe në materialin e kërkuar për çasje i keni pranuar edhe ju të njejtat.Dua vetëm t'ua përkujtoj se ne kemi konstatuar se kontrata e cekur me Mabco Construction ka qenë kontratë e rregulltë pasi që ka rezultuar se nuk e ka bazën kontraktuese në Institucionet publike si që pretendoni ju dhe si që e kemi menduar edhe ne,por është kontratë e bazuar në një donacion të huaj për fondacionin "Jahjaga",repektivisht donatori është HH Sheikha Fatima Bint Mubarak dhe në bazë të kësaj pjesa prej 6.649,980.28 euro është kontraktuar në mes të Mabco Construction dhe Fidola SHPK dhe për këtë janë dorëzuar dëshmitë e realizimit të kontratës dhe dëshmitë e pagesave nga bankat.Bazuar në këtë është pranuar kjo referencë e këtij tenderuesi,pasi qe eshte konstatuar se pranimi perfundimtar eshte bere me 31.12.2019 dhe per kete jane kerkuar dhe jane pranuar edhe deshmite e pagesave te vertetuara nga Banka;
-Pretendimet lidhur me çertifikatat nuk janë të bazuara,pasi që dokumentet origjinale që i kemi pranuar jo vetëm që janë të barasvlershme me kopjet e noterizuara,por edhe më të pranueshme se të njejtat.Poashtu ju sqarojmë se me formularin B 54-Njoftimin mbi korigjimin e gabimeve jeni njoftuar se nuk duhet dorëzuar gjashtë çertifikata sipas kërkesave nga njoftimi për kontratë,por katër çertifikata,të cilat edhe i ka dorëzuar tenderuesi i rekomanduar për dhënje të kontratës dhe bazuar në këtë ato çertifikata është trajtuar i pranueshëm.

Pas këti vendimi ne i jemi drejtuar OSHP-së e cila në mënyr decitive cekë për pretendimet tona:

Paneli shqyrtues shqyrtoj dhe analizoj pretendimet ankimore të OE të parë ankues "Rexha" shpk

Sa i përket pretendimit të OE ankues "Rexha" se autoriteti kontraktues e ka eliminuar pa të drejtë duke u arsyetuar se nuk kemi dorëzuar referenca të ndërtimit të lartë, kjo nuk qëndron pasi që AK në sqarimin e datës 31.01.2020 ka cekur "Nuk pranohen eksperienca e punës së renovimeve, por pranohen referencat e ndërtimeve te larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit te nenit 3 paragrafi 1.10 te ligjit për ndërtim NR.04 L-110". Ne kemi prezantuar të gjitha kontratat/referencat që tejkalojnë këtë vlerë dhe për këtë është dëshmitar edhe vetë AK pasi që kemi kontrata me ata.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit sqaron se kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë: **Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ndertimeve te reja, (ndertim i larte) ne vlere minimale prej 7,500,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontrat (ne rast konzorciumi udhëheqesi i konzorciumit duhet te plotesoj te paktën 60% te kerkeses).**Ndërsa dëshmitë e kërkuara në dosjen e tenderit për këtë pikë ka qenë: **Një listë te kontratave** të realizuara, duke **plotësuar Aneksin 4 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve.** Lidhur me këtë pikë ka pasur edhe pyetje sqaruese që ju ka dërguar AK-së nga një OE gjatë kohës së marrjes së dosjes së tenderit dhe përgjigjja për këtë është dhënë nga AK me datë 31.01.2020. Pyetja sqaruese nga një OE ka qenë: "Pasi qe edhe renovimet e objekteve hyjnë ne kategorinë e ndërtimit te larte, atëherë a mund te na tregoni se a njihen si referenca eksperienca e punës ne renovimin e objekteve te larte?" Lidhur me këtë pyetje është përgjigjur AK me datën 31.01.2020 me këtë sqarim: "Nuk pranohen eksperienca e punës së renovimeve, por pranohen referencat e ndërtimeve te larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit te nenit 3 paragrafi 1.10 te ligjit për nderim NR.04 L-110" Meqenëse OE ankues ka tenderuar si konzorcium dhe lideri i konzorciumit është OE "Rexha", atëherë sipas kërkesës së DT, i bie që lideri duhet ti ketë projekte të kryera në vlerë prej 4.500.000.00 € dhe referencat, apo raportet e pranimit për këto projekte. AK ti sqaroj kontratat e OE ankues konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së nga lista e ofruar se a e plotësojnë këtë kërkesë te AK-së.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Rexha" se AK nuk ka marrë për bazë qarkullimin e dërguar nga ATK për vitin 2016, 2017 dhe 2018 si dhe qarkullimin nga banka për vitin 2019 dhe nuk ka kërkuar sqarime shtesë për këtë çështje por e ka vlerësuar si pikë e pa plotësuar. Po ashtu edhe për pozicionin nr.9 në paramasë te objekti 3 se është i përsëritur dy herë. AK nuk e vlerëson në pajtim me nenin 59 pika 3 si tolerancë deri 2% të vlerës totale të ofertës. Paneli shqyrtues vlerëson se sa i përket qarkullimi të OE ankues për tri vitet e fundit, në një formë edhe vetë AK e ka pranuar ne përgjigjeje te kërkesë për rishqyrtim se arsyeja pse nuk është kërkuar sqarime shtesë, ka qenë për shkak se OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën për projektet e kryera dhe referencat e dorëzuar dhe ne këtë rast një sqarim i tillë pavarësisht rezultatit nuk do të kishte efekt. Ndërsa përsëritja e pozicionit në fjalë ekziston në ofertën e OE ankues, mirëpo i njëjti nuk është arsye për eliminim sepse mundet të trajtohet si devijim i vogël sipas nenit 59 të LPP-së dhe nuk e kalon vlerën prej 2% te totalit te ofertës, andaj ky pretdnim ankimor është i qëndrueshëm.

Pretendimin tjetër i OE ankues "Rexha" se autoriteti kontraktuesi ka pranuar OE të rekomanduar për kontratë certifikatat ISO të pa noterizuara, kur kërkesa në DT ka qenë se duhet të janë të noterizuara, paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë, çertifikatat ISO i ka ofruar në origjinal. Duke pasur parasysh faktin se kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë "...certifikat ISO të noterizuara", dhe duke pasur parasysh faktin se dokumentet janë dorëzuar në mënyrë elektronike përmes sistemit të e-prokurimit dhe jo në kopje fizike, paneli shqyrtues vlerëson se AK ka qenë dashur që këtë çështje ta sqarojë me operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë më saktësisht të kërkoj nga OE që të njëjtat ti sjellë konform kërkesës, andaj paneli shqyrtues obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të kërkoj konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së informata shtesë nga OE i rekomanduar më saktësisht certifikatat ashtu siç ka qenë kërkesë e vet AK-së.

Ju pas këti vendimi keni kërkuar sqarime nga ana jonë por se nuk i keni marrë përbazë madje për eliminim të ofertës tonë keni përdorur të njejtat pretendime duke bërë shkelje ligjore të LPP-së vendimit të OSHP-së por edhe vetë vendimeve tuaja.
Me datën 07.10.2020 kemi pranuar vendimin tuaj ku për çudi keni vepruar njejtë si herën e parë por kësaj radhe vetem se keni rritur shkallën e shkeljes ligjore dhe vendimeve tuaja dhe OSHP-së.

Duke parë se nuk ka pasur ndonjë efektë kërkesa e parë ku kemi shfaqur prova të mjafëtueshme se nuk keni vepruar drejtë ndaj ofertës tonë por edhe ndaj OE të rekomanduar për kontratë.

Sa i përket pretendimeve tuaja me të cilat na keni eliminuar ofertën tonë ne qëndrojm prara sqarimeve tona kërkesave për rishqyrtim dhe ankeses tonë për të cilat edhe ju edhe OSHP keni pranuar që kanë qenë jo të drejta.

Provë:Vendimi juaj në kreksen për ri-shqyrtim i datës: 05.06.2020
Provë: Vendimi OSHP i datës: 12.08.2020.
Provë:Përgjigjëja jonë për sqarim e datës: 27.09.2020.

Por duke parë që vendimi juaj është prap i njejtë ne prap kemi kërkuar qasje dhe kemi gjetur këto pa rregullësi.

Sipas vendimit të OSHP-së ju është dashur të na kërkoni sqarime dhe të pranoni referencat konform DT dhe sqarimeve tuaja por ju nuk i keni marrë për bazë vendim të cilin ju lusim ta ri-shiqoni.

Ne pas qasjes në oferten kemi parë se kërkesat tuaja në DT siq janë:

3. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.	**3. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim.**

Aneksi 8. PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM dhe AFATI PËR KRYERJEN E PUNIMEVE

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)
1	Vinç	1
2	Eskavator	3
3	Kamion vetshkakrues min 10 m³	6
4	Cilinder për kompaktimin e tamponit	2
5	Grejder	1
6	Cisterne e ujit	1
7	Luge ngarkuese	2

Ky OE përveq se nuk e ka plotësu ar këtë list për VINÇ nuk ka ofruar dëshmi fare që e plotëson por që më pas e keni kërkuar ju në mënyrë të paligjëshme pasi që nuk mundë të kërkohen sqarime për diqka që nuk ka deklaruar që e posedon.

Lidhur me kërkesën tuaj

6. Operatori Ekonomik	**6. Deklarate nga OE**

duhet të ketë mesataren e punëtorëve të punësuar minimum 100 punëtor për vitin 2017, 2018 dhe 2019.	

OE në fjalë nuk ka doërzuar deklratë fare dhe nuk e kuptojm se si keni shpallur të përgjegjëshme konform LPP-së në momentin e mos deklarimit oferta duhet të shpallet e papërgjegjëshme.

Lidhur me kërkesën tuaj:

o Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyres se ngjashme (ndërtim i larte).	CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. • Referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).

OE në fjalë përveq që ka dorëzuar një person i cili nuk e ka të kryer në fushën adekuate nuk ka as përvojë pune konform kërkeses tuaj sepse
Bujar Zeqiri i diplomuar me datë 08.12.2015 në drejtimin master i shkencave të inxhineris elektrike nuk plotëson kërkesen tuaj pasi që keni cekur: Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.
Në CV e tij ka cekur se ka filluar përvojen me datë 01.05.2016 që i bie më pakë se 5 vite përvojë pune.
Provë CV dhe diploma e dorëzuar me ofertën.

Pas kësaj kërese me datë 15.10.2020 AK ka aprovur të gjitha këto pretendime dhe ka këthyer lënden në ri-vlerësim . Ku ka cekur:

1.Aprovohet si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga " Rexha SHPK" e dates 12.10.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Tregu i ri i qytetit ", me Nr. të Prok: 616 19 9686 511 , kundër Vendimit te AK –së, të datës 07.10.2020.
2.Autoriteti Kontraktues, vendos qe aktivitetin e prokurimit me titull "Tregu i ri i qytetit", me Nr. të Prok: **616 19 9686 511 ta kthej ne rivlerësim.**
3.Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 15.10.2020 ka shqyrtuar kërkesën e grupit të OE-ik "Rexha SHPK&"dhe lidhur me pretendimet e të njejtit ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi lidhur me mosrespektimin e Vendimit te OSHP-se lidhur me sqarimet per vleren e projekteve te realizuara eshte pjeserisht i bazuar,pasi qe Autoriteti Kontraktues ka kerkuar sqarimin tuaj lidhur me ate pse ju pretendoni se e plotesoni kete kerkese,mirepo nga komisioni nuk eshte pranuar qe te trajtohen projektet qe nuk jane dorezuar me oferten tuaj,edhe pse disa

kane qene te perfshira edhe ne oferte.Per kete arsye une si zyrtar pergjegjes i prokurimit e kam vleresuar si te pranueshme referencen nga QKUK-ja,por duke u bazuar ne mungesat profesioanle nuk kam mund te jap vleresim meritor per disa kontrata tjera si :"Ndertimi i Bulevardit mbi "Kurriz",Ndertimi i parkut ne Lagjen "Arberia"dhe ndonje projekt tjeter qe ju keni pretenduar se i takojne ndertimit te ri,respektivisht ndertimit te larte.Pra per keto shkaqe ky ekzaminim nuk eshte bere deri ne fund dhe kerkoj qe kjo te behet ne fazen e rivleresimit;

-Sa i perkeet perseritjes se paramases,komisioni e ka trajtuar si devijim te pa pranueshem,ndersa Vendimi i OSHP-se ka rekomanduar qe te trajtohet si tolerance e çmimit te ofertes dhe kjo duhet te analizohet ne rivleresim sipas rekomandimit te OSHP-se dhe per kete ky pretendim trajtohet si i bazuar;

-Pretendimi qe ka te beje e çertifikatat eshte respektuar dhe OE-ik i rekomanduar per kontrate i ka dorezuar çertifikatat e noterizuara permes adreses elektronike,mirepo ne forme fizike nuk jane pranuar;

-Pretendimi se Autoriteti Kontraktues ka bere veprime te ndryshme lidhur me sqarimet shtese eshte plotesisht i bazuar,pasi qe kam konstauar se ne tenderin per Rindertimin e rruges "Muharrem Fejza"tenderuesi me çmimin me te lire "Kema Company"eshte eliminuar per faktin se tri mjete pune nuk i ka paraqitur as ne liste dhe as nuk ka ofruar deshmi tjera.Poashtu OE-ik "Rexha"eshte eliminuar vetem per faktin se nuk ka mund te deshmoj se nje paisje,respektivisht kamion cisterne ka libreze valide me afat te regjistrimit.Pra ne rastin e vleresimit te tenderit per Tregun e ri te qytetit kur eshte kerkuar qe te sqaroj pse nuk ka ofruar vinçin si paisje per pune konzorciumi perpos sqarimit ka dorezuar edhe deshmite per vinç dhe i jane pranuar e qe d.t.th.se per rast te njejte eshte vepruar ndryshe.Pra ne rivleresim duhet te shqyrtohet ky veprim dhe te vleresohet a ishte ky veprim i ligjshem apo jo,pasiqe per rastet e njejta duhet bere veprime dhe trajtime te njejta.

-Pretendimet lidhur me deklaraten per numrin e te punesuareve keni pjeserisht te drejte,por Autoriteti Kontarktues eshte bazuar ne deshmite e dorezuara-listat e te punesuareve sipas te cilave grupi i OE-ik e ploteson kete kerkese;

-Lidhur me pretendimin per pervojen e inxhinierit te elektros tuaja ju sqaroj se sipas meje eshte pjeserisht i bazuar dhe vlen pergjegja e njejte si per nje pretendues tjeter ne kete aktivitet:" duke analizuar dëshmite e dorëzuara për stafin kam konstatuar se pervoja e nje inxhinieri (inxh.i elektros)nuk eshte aqe sa eshte kerkuar,mirepo edhe gjate vleresimit e edhe tani komisioni profesional ka konstauar se ajo paraqet devijim te vogel dhe se i njejti ploteson kriterin tjeter-deshmite e menaxhimit te se paku dy kontratave te ngjajshme. Ne fazen e rivleresimit paraprak i eshte kerkuar edhe diploma e bachelorit dhe e ka dorezuar,por bazuar ne kerkesen e FDT-se qe duhet te jete inxhinier i diplomuar me pese vite pervoje pas diplomimit rezulton qe nuk i ka pese vite pervoje pune me kete titull,por kjo pervoje plotesohet nese merret per baze edhe pervoja si bachelor.
Pasi qe aktiviteti kthehet ne rivleresim eshte detyre e komisionit ta vleresoj drejt kete kriter,pasi qe ka qene rekomandim edhe i Vendimit te OSHP-se.

Por me datë 12.11.2020 na ka eliminuar për të njejtata arsye

"Rexha"shpk,"Arhiko ingO.P" NPN "Euroing"shpk

1. Nga ATK ka dorëzuar qarkullim 2.8mil€(duhet me qenë 6mil. Euro), ndërsa për vitin 2019, ka sjell deklarate nga banka , se ne vitin 2019, ka pas qarkullim në vlerë 2,623,087.32€, , edhe me këtë vlerë nuk e mbulon vlerën e kërkuar të qarkullimit për lider që duhet të jetë 6mil.
2. Nuk ka prezantuar referenca për ndërtim të lartë (nuk ka ofruar dëshmi , për punët e ndërtimit të lartë që duhet të jetë 4.5mil euro)
3. Në paramasë, te objekti 3, poz. Nr. 9, Punët e fasadës , pozicioni 9.1 është përsërit dy herë , gjë që ndryshon nga paramasa e ofertuar

Komisioni i rivlerësimit ka konstatuar mungesat e njëjta te cekura me larte dhe ka deklaruar se nuk duhet te trajtohen referencat dhe kontratat te cilat OE i ka dërguar me sqarimet e veta e qe nuk janë paraqitur ne oferte.

Konstatimet e detajuara te komisionit dhe te udhëheqësit te prokurimit janë paraqitur ne Raportin e rivlerësimit.

Pas këtyre veprimeve ne me datë 13.11.2020 kemi bërë kërkes për ri-shqyrtim ku kemi kërkuar nga AK të na sqaroj këto veprime dhe kemi marrë këtë përgjigjëje:

VENDIM

1.Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "REXHA SHPK"e datës 13.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit" Tregu I ri I qytetit" **dhe me numer te prokurimit 616 19 29 511** kundër njoftimit te vendimit te AK –së, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

2.Autoriteti Kontraktues, vendos që te vazhdoj aktivitetin sipas publikimit te dates 12.11.2020.

3.Ky vendim i korigjuar hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "REXHA SHPK" me datë 13.11.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:**" Tregu i ri i qytetit",dhe me numer te prokurimit** 616 19 29 511

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.11.2020 ka rishqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Te gjitha pretendimet e paraqitura ne kete kerkese janë trajtuar ne kërkesat paraprake dhe poashtu janë trajtuar edhe nga komisioni i rivlerësimit,mirëpo do ti cek shkurt edhe disa sqarime:

-Eshte konstatuar se dëshmia per vinç nga tenderuesi i rekomanduar per kontrate eshte kërkuar pa pase dëshmi as ne tender e as si mjet i paraqitur ne liste,mirëpo kjo ka ndodhur dhe nuk ka efekt te kthehemi ne vlerësimin e pare.Kjo mund te jete siqe e quani ju e paligjshme,mirëpo tani nuk mund te riparohet;

-Lidhur me pretendimet tuaja per kualifikimet e stafit(inxhinieri e elektros)ju sqaroj se kam kërkuar sqarime plotësuese nga komisioni edhe pas dorëzimit te rekomandimit,por ata e konsiderojnë si devijim te vogël dhe e bëjnë si anëtar te pranueshëm te stafit:dhe
-Te gjitha pretendimet tuaja dhe sqarimet e dërguara nga Instituionet tjera i kam percjellur me kohe dhe kame kërkuar trajtim nga te njëjtit dhe pergjegjet e tyre janë si pjese e rekomandimit te tyre përfundimtar.
Nga kjo rrjedh se une nga pozita ime i kam percjellur te gjitha kërkesat tuaja te komisioni i rivlerësimit dhe ata si komision profesional i kane trajtuar si te pamjaftueshme qe ju te jeni tenderues i përgjegjshëm dhe ne kete menyre përgatitja ime profesionale me ka detyruar te pajtohem me rekomandimin e tyre dhe te njëjtin e kam aprovuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Me këtë arsyetim vetë AK e pranon se nuk ka qenë në gjendje të marrë veprim të drejtë dhe ligjor me vetë faktin se menagjeri i prokurimit pranon se nuk ka qenë në "gjendje" të marrë veprime ligjore ose ka lejuar dhe ka nënshkruar vendime të paligjëshme të cilat i cilëso edhe vetë ai në vendimin e tij.

Panel i nderuar duke parë si adresën e vetëme OSHP-në për trajtim të duhur të pretendimeve tona kërkojm nga ana juaj të aprovoni ankesen tonë dhe lënden ta këtheni në ri-vlerësim duke urdhëruar AK të zbatoj vendimin tuaj.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "PE-VLA-KU"SHPK -PRISHTINË

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- **Neni 1 i LPP- së**
- **Neni 7 i LPP- së**
- **Neni 27 i LPP-së**
- **Neni 28 i LPP-së**
- **Neni 51 i LPP-së**
- **Neni 56 i LPP-së**
- **Neni 59 i LPP-së**
- **Neni 68 i LPP-së**
- **Neni 69 i LPP-së**
- **Neni 70 i LPP-së**
- **Neni 71 i LPP-së**

- **Neni 72 i LPP-së**
- **Neni 2 i RRUOPP-së**
- **Neni 26 i RRUOPP-së**
- **Neni 27 i RRUOPP-së**
- **Neni 39.8 i RRUOPP-së**
- **Neni 41 i RRUOPP-së**

Gjatë procedurës së aktivitetit të prokurimit Autoriteti Kontraktues:Komuna e Prishtinës ka bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik dhe të Rregullave dhe Udhëzimeve Operative për Prokurim Publik,përkatësisht neneve të lartëcekura duke devijuar nga kriteret e vendosura në Dosjen e Tenderit.
Me datën 12.10.2020 ne operatori ekonomik "PE-VLA-KU"Shpk kemi bërë kërkesë për rishëyrtim tek Autoriteti Kontraktues:Komuna e Prishtinës me pretendimet e cekura në kërkesë.

Provë:Kërkesa e bashkangjitur

Autoriteti Kontraktues:Komuna e Prishtinës,me datën 15.10.2020 ka sjelle vendimin ku kërkesën tonë për rishqyrtim e ka aprovuar si pjesërisht të bazuar si dhe ka kthyer lëndën në rivlerësim.

Provë:Bashkangjitur gjeni vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 15.10.2020

Me datën 12.11.2020 Autoriteti Kontraktues:Komuna e Prishtinës ka sjelle B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues,në të cilin ne si OE na ka shpallur të pasuksesshëm,ngase tenderi yne nuk është me çmim më të ulët dhe përseri ka shpallur fitues konzorciumin :JV'Fidola"Shpk &"Nartel Exin:Shpk me çmimin më të ulët 4,492,218.41 €.

Prove:Të bashkangjitur e gjeni Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues,Komunës së Prishtinës të datës 12.11.2020.
-Ne po atë datë kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare për operatorin ekonomik të shpallur fitues.Qasja na është mundësuar me datën 13.11.2020 nga Autoriteti Kontraktues:Komuna e Prishtinës ku na është dhënë dosja dhe letrat standarde në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik të shpallur ri-fitues.

Prove: Të bashkangjitur e gjeni kërkesën tone pqe qasje të datës 13.11.2020

-Pas analizimit të dosjes së tenderit nga ana jonë,kemi vërjetur parregullsi tek dosja e tenderit të operatorit ekonomik fitues edhe pas shume letrave standarde të Autoritetit Kontraktues:Komunës së Prishtinës për sqarime të dosjes së tenderit edhe për dokumente shtesë të konzorciumit;JV "Fidola"Shpk & "Nartel Exin"Shpk nuk i kane përmbush kërkesat e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues.Në mënyrë kronologjike sipas kërkesave të dosjes së tenderit janë të renditura parregullsite që kemi në dosjen e Operatorit Ekonomik fitues:
-Marrëveshja e konzorciumit e paraqitur nga JV "Fidola"Shpk & "Nartel Exin"Shpk nuk është marrëveshje e kompletuar pasi që mungojne të dhënat e tenderit,titulli i projektit,numri i prokurimit si dhe sipas pikës 11.1 adhe b i mungojnë:
a) një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtaret e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për

përmbajtjen e grupit të tenderit dhe në rast se grupit i jepet kontrata për ekzekutimin e kontratës.
b) nje deklaratë e nënshkruar nga secili anetarë,duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njejtë të prokurimit:
-Deklarata nën betim e operatorit ekonomik "Nartel Exin :Shpk është pa datë.
-Mungon Deklarata për Specifikacione Teknike,deklarata në fjalë nuk është paraqitur nga ana e konzorciumit, Neni 28 i LPP-Specifikacioni tekni është i obligueshëm që të jetë.Neni 39.8 i Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik –tek pjesa si te veprohet për mungesë të kësaj deklarate,është refuzimi i tenderit pa kërkuar informata sqaruese.

-Në dosje te tenderit tek pika 7.1 &7.2,Kërkesa e përshtatshmërise profesionale.Autoriteti Kontraktues :Komuna e Prishtinës ka kërkuar ISO standardet të noterizuara:

ISO 9001 2015
ISO 14001 2015
OHSAS 18001 2007
ISO 27001 2013
ISO 39001 2012
PAS 99 2012

Konzorciumi JV "Fidola"Shpk & "Nartel Exin"Shpk i ka paraqitur këto ISO standarde

ISO 9001 2015
ISO 39001 2012
ISO 45001 2018
ISO 14001 2015
Të cilat nuk janë të noterizuara sipas kërkesës së dosjes së tenderit,konzorciumit në fjalë i mungojnë:

OHSAS 18001 2007
ISO 27001 2013
PAS 99 2012
Ku edhe pas kërkesës për sqarim nga Autoriteti Kontraktues,Konzorciumi përsëri nuk i ka sjellur ISO të noterizuara dhe të kompletuara.

Gjitashtu vlen të cekët se ISO 9001 2015 i ka skaduar afati me datën 30.04.02020 dhe po të njejtën edhe pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues nuk e ka sjellur të vazhduar.

-Sipas kërkesës 8.1&8.2 Kërkesa mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të dosjes së tenderit si dhe nenit 68 të LPP-së,Gjendja ekonomike dhe Financiare e Operatorëve.Operatori duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i operatorit ekonomik gjatë tri viteve të fundit ka qenë jo më pak se 10,000,000.00 €,në rast të konzorciumit lideri duhet të plotësoj 60% të kërkesës,këtu duhet të prezentohen deklarata tatimore vjetore për tri (3) vitet e fundit ose kopjet e raporteve financiare nga një firmë e licencuar dhe një auditor i pavarur.
Vërehet qartë se konzorciumit të lartë cekur i mungojnë Deklaratat tatimore Vjetore për 2019,gjithashtu anëtarit të konzorciumit Nartel Exin nuk e ka paraqit qarkullimin vjetor as nga ana bankare e as nga ATK për tri vitet e

fundit si dhe "Fidola" Shpk nuk e përmbush qarkullimin si lider me 60% sipas deklaratave tatimore të paraqitura për vitin 2018 dhe 2017 qarkullimi i tyre është në vlerën prej 1,862,870.69 €.E njejta situatë është edhe për pjesëmamrrësin tjetër të konzorciumit operatorin ekonomik "Nartel Exin"Shpk.Vlen të cekët se në kohën kur është bërë dorëzimi i tenderit nuk ka qenë gjendje e jashtëzakonshme(gjendja pandemike) dhe që deklaratat tatimore 2019 kane mund të merren ke Adiministrata tatimore e Kosoves 'ATK" si në mënyrë elektronike ashtu edhe fizike.

-Sipas pikës 9.1 dhe 9.2- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose profesionale,vërejme që stafi i prezentuar i inxhinierëve nuk është plotësisht i përputhshëm sipas kritereve të dosjes së tenderit.

-CV e inxhiniereve nuk janë të nënshkruara nga vetë inxhinierët.

-Inxhinierin e Makinerisë të cilin e kanë prezentuar nuk është në përputhje me kriteret e dosjes së tenderit-në dosje kërkohet inxhinier i makinerisë drejtimi termoenergjetik,ndërsa konzorciumi ka prezentuar inxhinier të diplomuar të makinerisë.

-Mungon Inxhinieri i Hidroteknikës pasi që me kontrata e kanë paraqitur dy inxhinier të arkitekturës ndërsa me dilplomë njëri është inxhinier i hidroteknikës.

-Konzorciumi i lartëpërmendur nuk e përmbush edhe kriterin për punë të ngjashme,referenca nga kompania Dugagjini për objektin Afaristo banimor,Blloku A1 Lakërishte,Prishtinë në vlerë prej 4,608,074.67 ,në këtë reference thuhet që punimet kanë filluar në nëntor 2015 dhe kanë përfunduar në dhjetor 2018 ndërsa referenca është lëshuar në prill 2017,pra referenca e punimeve është lëshuar një vit më përpara se të përfundojnë punimet për këtë objekt.

Referenca nga Agro Trade&Fidola Construction shpk për objektin Afaristo –Banimor Ëorld Trade Center Prishtina ,punime në këtë objekt kanë filluar në prill 2016 dhe kanë përfunduar në dhjetor të vitit 2019-këtu vërejmë Fidola Construction i ka lëshuar reference vete vetës,pasi që në ndërtimin e këtij projekti është në konzorcium me kompanine Agro Trade.

Referenca nga Mabetex Group e datës 05.02.2020,për punë të kryera nga Spitali Pediatrik dhe Kirurgjisë Pedriatike në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë nuk është cekur vlera e çmimit të ndërimit të projektit si dhe në listën e paraqitur nuk është cekur data e përfundimit të projektit.

I njejti rast është edhe me referencën nga NTP Medica shpk ku për projektin Ndërtimin e Fabrikës së Gazit Mjekësor dhe Industrial në Obiliq nuk është cekur vlera e projektit.

Gjithashtu në listën e paraqitur për punë të ngjashme kompania "Fidola"Shpk ka paraqitur në listë një kontratë(objekt)"Ndërtimi i objektit banesor-afariste 3B++9ET të pa përfunduar por vetëm që është në porces e më sipër.Ndërsa kompania "Nartel Exin"Shpk ka të paraqitur vetëm listën e punëve të ngjashme dhe nuk ka asnjë reference,pranim teknik ose procesverbal për të vërtetuar që ka përfunduar këtë punë.

-Konzorciumi JV: "Fidola"Shpk & "Nartel Exin"Shpk nuk e ka kompletuar listën e makinerive siç është kërkuar në dosje të tenderit.Vërejmë që të gjitha marrëveshjet me qera për makineri nuk janë me të dhënat e tenderit(titulli dhe numri i prokurimit).

Vërejmë që cisterna e ujit me targat 01-329-LB nuk është cisternë e ujit por kamion special.
Marrëveshja me qera me personin fizik Anver Aliu për marrjen në shfrytëzim të makinerive hasim në të dy kontratat e paraqitura nga konzorciumi që dudat doganor dhe të dhënat në kontratë nuk janë në përputhje..Nga këto vërejmë që makineria Eskavator,marka Akerman viti i prodhimit 1995,ngjyra e verdhë nuk është në emër të përsonit fizik Enver Aliut por të NTPSH Vllezerit Ramadani,si dhe makineria Eskavator Caterpiller,viti i prodhimit 1981edhe ky është në emër të përsonit fizik Nasim Zenaj e jo përsonit fizik Enver Aliut si në kontratë të qerasë edhe marrëveshja për marrjen në shfrytëzim të makinerisë për ngarkuesën është në kundërshtim me dudin doganor dhe kontratën.Kjo përsëritet edhe në shumë kontrata të tjera në mes të këtyre palëve.
Kamioni me targat 01-971-MG është i paidentifikueshëm regjistrimi i tij (nuk shihet qartë)
Kamionat me tagat 01-745 Jn dhe 01-957-NK janë të paregjistruar.

Sipas kërkesës së dosjes së tenderit,lideri i konzorcioimit duhet të ketë së paku 60% të kërkesave në pronësi të tij,por që konzorciumi i lartëpërmendur nuk ka asnjë makineri dhe as një dokument tjetër në emër të tij si lider,pra nuk e plotëson kriterin bazë te plotësimit të 60% të të pasurit të dokumentacionit të liderit.

Provë: Të gjitha këto pretendime tona i kemi të bashkangjitura në Ankesë.

-Kërkesa nga dosja e tenderit që operatori ekonomik të ketë minimumin 100 punëtor për vititn 2017,2018 dhe 2019 si dhe të ketë deklaratë nga operatori ekonomik të nënshkruar dhe vulosur,konzorciumi JV "Fidola"Shpk & "Nartel Exin"Shpk nuk i kanë të kompletuar,pasi që Operatorit Ekonomik "Fidola"Shpk i mungon lista përpiluar,nënshkruar dhe vulosur nga kompania e operatorit ekonomik "Nartel Exin"Shpk nuk i ka listat nga ATK-ja.

-Konzorciumi në fjale nuk i ka nënshkruar dhe vulosura marrëveshjet për gurëthyes dhe për beton.këtë ka bërë vetëm pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues:Komuna e Prishtinës.
-Konzorciumi JV "Fidola"Shpk & "Nartel Exin"Shpk i shpallur fitues për projektin me titull:Tregu i ri i qytetit me numër të prokurimit:616-19-9686-5-1-1 nuk e ka dosjen e rregullt sipas kërkesave të dosjes së tenderit,në asnjë pikë nuk është tenderi i tyre në përputhshmëri me kërkesën e dosjes së tenderit.
Edhe pse Autoriteti Kontraktues:Komuna e Prishtinës,i ka kërkuar sqarime operatorit ekonomik fitues JV "Fidola"Shpk & "Nartel Exin"Shpk,të njejtit nuk i kanë sjellur sqarimet e nevojshme sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues edhe prapë pas kësaj është shpallur fitues.

-Të gjitha këto konstatime dhe prova të bashkangjitura vërtetojnë se Autoriteti Kontraktues:Komuna e Prishtinës në rastin konkret në mënyrë flagrante ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të lartëcekura të LPP-së.

-Nga të cekurat më lartë i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) që Ankesa jonë të aprovohet si e bazuar dhe që i njejti ta rishqyrtoj vendimin e Autoritetit Kontraktues si të gabuar dhe jo të plotë dhe të bëjë përmirësimin e vendimit dhe të kthej lëndën në lëndën në Ri-Vlerësim duke na rekomanduar ne për shpërblim me kontrate.
-Në rast të ndonjë paqartësie ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni me qëllim të qartësimit të kërkesës sonë.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE "RAF II"SHPK -RAHOVEC

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- **Neni 1 i LPP- së**
- **Neni 7 i LPP- së**
- **Neni 59 i LPP-së**
- **Neni 60 i LPP-së**
- **Neni 64 i LPP-së**
- **Neni 69 i LPP-së**

Te nderuar,ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se me dt.12.11.2020, ku e ka rekomanduar per kontrate OE "FIDOLA&Nartel EXIN",ndersa neve na ka shpallur si tenderues te pasuksesshem.

Ju sqarojme se AK-ja na ka diskriminuar neve si OE i pergjegjshem ne kete aktivitet te prokurimit pasi qe ka rekomanduar per kontrate nje OE i cili eshte i papergjegjshem sepse nuk i ka perrnbushur te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate sepse tek Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale,tek neni 9.1&9.2 kerkese ka qene: *"Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) me 5 vite pervoje pune pas dipiomimit. Duhet te kete udhehequr se paku 2 kontrata te natyres se ngjashme ndertim i larte) "*,ndersa si deshrni dokumentare eshte kerkuar *"CV-a, Diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marreveshja mbi angazhimin per kete projekt. Referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike) ".*

OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar kerkesen e lartcekur sepse inxhinierin te cilin e ka ofruar,ky inxhinier nuk e ka pervojen e punes prej 5 viteve ashtu sic eshte kerkuar ne FDT dhe tek njoftimi per kontrate, pra nuk e ploteson kerkesen e lartperrnendur,andaj edhe eshte dashur te shpallet si i papergjegjshem dhe jo te rekomandohet per kontrate nga ana e AK -se.

Inxhinieri ne fjale ka perfunduar studimet me dt. 08.10.2015 ndersa njoftimi per kontrate eshte bere me dt. 30.12.2019, pra nese llogaritet data e diplomimit te inxhinierit dhe data e njoftimi per kontrate, shihet qarte se inxhinieri i elektroteknikes i prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate nuk e ploteson kerkesen e lartpermendur,dhe eshte dashur te shpallet i papergjegjshem,pasi qe pese vite pervoje pune prej momentit te diplomimit i njejti inxhinier i bene me dt.08.10.2020,mirepo ne asnje menyre nuk eshte dashur te rekomandohet per kontrate nje OE i cili eshte i papergjegjshem.Mirepo edhe pse OE i rekomanduar per kontrate nuk e ploteson kerkesen e lartcekur AK-ja,perseri e ka rekomanduar per kontrate,duke e favorizuar haptas OE te rekomanduar per kontrate dhe njekohesisht duke na diskriminuar neve si OE i pergjegjshem.

Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem edhe per faktin se nuk i ka plotesuar kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale, neni 9.1&9.2, perkatesisht kerkesa Nr.3 Lista e pajisjeve teknike ku ne listen e makinerise te cilen e ka ofruar OE i rekomanduar per kontrate, tek deshmite per kamiona shihet qarte se Kamioni me targa 01-745-JN dhe Kamioni me targa 01-957-HK iu ka skaduar afati i regjistrimit para njoftimit per kontrate,andaj AK-ja eshte dashur ta merr parasysh kete fakt,pasi qe po shihet qarte favorizimi qe po i behet OE te rekomanduar per kontrate dhe njekohesisht diskriminimi qe po na behet neve si OE i pergjegjshem. Po ashtu edhe Kamionit me targa 01-745-JN i ka skaduar regjistrimi me dt.24.07.2018,pra mbi nje vit e gjysme para dates se dorezimit te ofertave.Kamionit me targa 01-957-HK i ka skaduar afati i regjistrimit me dt.28.06.20 19, edhe pse nuk po shihet mjaft mire muaji i skadimit por gjithsesi po figuron se eshte para dates se fundit te dorezimit te ofertave,

Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem edhe per faktin se nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate perkatesisht kerkesat e pershtatshmerise neni 7.1&7.2 ku kerkese ka qene *"O.E. duhet te posedoj certifikaten OHSAS 18001 2007"*,ndersa si deshmi dokumentare eshte kerkuar *"Kopja e Certifikates te noterizuara"*, OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka ofruar fare certifikaten OHSAS 18001 2007,andaj edhe eshte dashur te shpallet i papergjegj shem dhe jo te rekomandohet per kontrate.

Po ashtu OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar edhe kerkesen tjeter te FDT-se ku kerkese ka qene *"OE duhet te posedoj certifikaten ISO 27001 2013 "*,ndersa si deshmi dokumentare eshte kerkuar *"Kopja e Certifikates te noterizuar"*. OE i rekomanduar per kontrate nuk e ka plotesuar kerkesen e lartcekur pasi qe nuk e ka ofruar fare certifikaten ISO 27001-2013

Andaj duke u bazuar ne faktet e lartcekura OE i rekomanduar per kontrate eshte dashur te shpallet i papergjegjshem dhe jo te rekomandohet per kontrate, pasi qe keto certifikata kane qene kerkesa decidive ne FDT dhe tek njoftimi per kontrate.Andaj duke e rekomanduar per kontrate nje OE i cili eshte i papergjegjshem, AK-ja na ka diskriminuar neve si OE qe i perrnbushim te gjitha kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate dhe njekohesisht e ka favorizuar haptas OE te rekomanduar per kontrate.

Ne me dt 20.11.2020 kemi marre pergjigje ne kerkesen per rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka deklaruar se refuzohet kerkesa per rishqyrtim, mirepo nuk ka dhene asnje pergjigje faktike dhe ligjore ne pretendimet tona ankimore.

Ne lidhje me arsyen e refuzimit te kerkeses tone per rishqyrtim,ju sqarojme se AK-ja edhe vete e ka pranuar se pretendimet tona jane te bazuara,pasi qe e ka cekur se inxhinieri i kerkuar nuk e ploteson kerkesen ne FDT dhe tek njoftimit per kontrate pasi qe nuk e ka pervojen prej 5 viteve, ndersa kete pretendim tonin per inxhinierin e lartpermendur e ka cilesuar si devijim te vogel. Eshte per tu habitur

fakti se si mund te quhet devijim i vogel perderisa nuk eshte perrnbushur kerkesa e kerkuar prej 5 viteve pervoje pune per inxhinierin e elektroteknikes, pasi qe kjo ka qene kerkese decidive ne FDT dhe tek njoftimi per kontrate dhe eshte kerkese kualifikuese kalon apo nuk kalon.
Nuk mund te konsiderohet devijim i vogel mos perrnbushja e kesaj kerkese sepse data e fundit per dorezirn te ofertave ka qene 10.02.2020,e qe i bie se ne momentin e dorezimit te ofertave i ka pasur mungese te pervojes se kerkuar rreth tete muaj.Nese do te merrej parasysh kjo kontrate dhe pervoje e punes se ketij inxhinieri do te favorizohej ky OE, ndersa me nje mungese te ketille me siguri se operatore ekonomik tjere nuk kane ofertuar duke e ditur se nuk e plotesojne kete kerkese decidive te kualifikueshmerise.
Andaj OE i rekomanduar per kontrate eshte dashur te shpallet i papergjegjshem pasi qe nuk e ploteson kerkesen e lartperrnendur.

Gjithashtu AK-ja eshte pajtuar edhe me pretendimin tjeter ankimor tonin,ne lidhje me kamionet te cilet jane me afat te skaduar te regjistrimit,mirepo ne arsyen e refuzimit te kerkeses tone per rishqyrtim e ka cekur se nuk ka qene kerkese qe regjistrimi duhet te jete valid.Mirepo ne ju sqarojme se nese kerkohen pajisje per kryerjen e puneve atehere duhet te jete edhe regjistrimi i tyre valid pasi qe dihet se cdo automjet i cili duhet te kryej pune dhe eshte i detyruar te dale ne komunikacion, duhet te kete regjistrim valid.
Andaj duke u bazuar ne faktet e lartcekura shihet qarte se arsyeja e AK-se per refuzimin e kerkeses tone per rishqyrtim eshte krejtesisht e pa bazuar dhe nuk qendron.Gjithashtu me

kete veprim te Ak-se po shihet qarte favorizimi qe po i behet OE te rekomanduar per kontrate dhe njekohesisht diskriminimi ndaj kompanise tone.

Duke u bazuar ne te gjitha deshmite dhe faktet qe u ceken me larte, konstatojme se ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve nuk eshte bere ne harmoni me nenin 59 te LPP-se sepse AK-ja ka rekomanduar per kontrate nje OE i cili nuk i ploteson te gjitha kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate, ndersa ne jemi ofertues i pergjegjshem duke i plotesuar te gjitha kerkesat e FDT-se dhe te njoftimit per kontrate dhe perseri nuk jemi shpallur si tenderues i suksesshem.

Duke u bazuar ne deshmite dhe faktet e lartcekura kuptohet qe nuk eshte respektuar edhe kriteri kryesor per dhenie te kontrates,e qe ka qene **tenderi i pergjegjshem me** çmim me te ulet,**sipas** nenit **60 paragrafi 1.1 i LPP-se.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 te LPP-se,sepse e ka favorizuar operatorin ekonomik te rekomanduar per kontrate duke e rekomanduar per kontrate, ndersa neve na ka diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotesuar te gjitha kerkesat e FTD-se dhe te njoftimit per kontrate. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne menyre te barabarte dhe jo-diskriminuese dhe do te veproje ne menyre transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qe Gjate udheheqjes se aktiviteteve te prokurimit, te gjitha autoritetet kontraktuese do te sigurojne;qe (vi) qe tenderi i zgjedhur te perputhet me te gjitha aspektet permbajtjesore te kushteve,kritereve dhe specifikimeve perkatese,mirepo AK-ja nuk i eshte permbajtur as kesaj dispozite ligjore.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka pasur ne konsiderate edhe nenin 1 te LPP-se,pasi qe dihet se qellimi i ketij ligji eshte te siguroje menyren me efikase,me transparente dhe me te drejte te shfrytezimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktuese ne Kosove.

Duke u bazuar ne te gjitha deshmite dhe faktet qe u permenden me larte,kerkojme nga OSHP qe te merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE ***"Raf II Shpk"***- Rahovec.
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per dhenie te kontrates dhe lenda kthehet ne **RIVLERESIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues qe gjate rivleresimit, ekzaminimi,vleresimi dhe krahasimi i ofertave te behet ne harmoni me kerkesat e dosjes se tenderit,njoftimit per kontrate dhe konform dispozitave te LPP-se.

Nese nuk merren parasysh faktet tona,ne jemi t e detyruar te vazhdojme proceduren ligjore ne institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

-Deklarata nën betim.
-Marrëveshja e konzorciumit

Përshtatshmëria profesionale:

3. *O.E. duhet te posedoj certifikaten ISO 9001 2015*
4. *O.E. duhet te posedoj certifikaten ISO 14001 2015*
5. *O.E. duhet te posedoj certifikaten OHSAS 18001 2007*
6. *O.E. duhet te posedoj certifikaten ISO 39001 2012*

Dëshmia- *Kopja e Certifikatës te noterizuara*

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa: *Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 10,000,000.00 Euro (ne rast konzorciumi udheheqesi i konzorciumit duhet te plotesoj te pakten 60% te kerkeses).*

Dëshmia: *Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i*

licencuar i pavarur..

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 1 *- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ndertimeve te reja, (ndertim i larte) ne vlere minimale prej 7,500,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontrat (ne rast konzorciumi udheheqesi i konzorciumit duhet te plotesoj te pakten 60% te kerkeses).*
Dëshmia 1 *- Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme ne vlere minimale prej 7,500,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontrat (ne rast konzorciumi udheheqesi i konzorciumit duhet te plotesoj te pakten 60% te kerkeses).*

Kërkesa 2 *-Inxhinier i diplomuar i elektroteknikes (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyres se ngjashme (ndërtim i larte).*
Dëshmia 2*- CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. • Referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).*

Kërkesa 2 *-Inxhinier i diplomuar i makinerisë (termoenergjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata te natyrës se ngjashme (ndërtim i larte).*
Dëshmia 2*- CV-a, Diploma. Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. • Referenca per Inxhinier i dip. i makinerise (termoenergjetike).*

Kërkesa 3 *Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.*
Dëshmia 3*-Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim*
Kërkesa 4*. Operatori Ekonomik duhet te ketë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr.*
Dëshmia 4*. Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjensioni për miniera dhe minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim.*

Kërkesa 5*.Operatori Ekonomik duhet te ketë Bazë për beton nga një kompani e licencuar ose marrëveshje për furnizim.*
Dëshmia 5*.Kopja e Licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Në rastet kur O.E. ka marrëveshje për furnizim, O.E. duhet të dorëzoj edhe kopjen e marrëveshjes për furnizim.*

Kërkesa 6*.Operatori Ekonomik duhet të ketë mesataren e punëtorëve të punësuar minimum 100 punëtor për vitin 2017, 2018 dhe 2019.*
Dëshmia 6*. Deklarate nga OE*

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE"Rexha"shpk-Prishtinë ,OE "Pe-vla-ku"Shpk-Prishtinë dhe OE "Raf II"Shpk-Rahovec, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Tregu i ri i qytetit": 616/19/9686/511,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"KK Prishtinë".

Duke u bazuar në raportin e rivlerësimit, komisioni rivlerësues ka konstatuar si në vijim:

Komisioni i rivlerësimit në raportin e tij të datës 11.11.2020,nga tetë (8) oferta të pranuara,katër (4) oferta i ka shpallur të përgjegjshme,duke rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të "Fidola" & "Nartel Exin"Shpk,si ofertë fituese në bazë të çmimit të poentuar me vlerë prej 4,492,218.41 €.

Sa i përket ofertes së OE ankues "Rexha"Shpk,nga komisioni i rivlerësimit kjo ofertë është shpallur e papërgjegjshme me arsyetimin se deklaratat e ATK-së për qakullim financiar nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit prej 6,000,000.00 € për liderin e konzorciumit,gjithashtu OE ankues nuk ka ofruar kontrata dhe referenca për ndërtim të lartë në vlerën e kërkuar (4.5 milion) siç është kërkuar në dosje të tenderit si dhe në paramasë të objektit nr 3,pozicioni 9.1është përsëritur dy here,gjq që ndryshon nga paramasa e ofertuar.

Sa i përket dy OE tjerë ankues "Pe-vla-ku"Shpk dhe "Raf II"Shpk,nga komisioni i rivlerësimit këto dy oferta janë shpallur të pasuksesshme sepse në bazë të çmimit të poentuar janë më të shtrenjtes sesa oferta fituese.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "REXHA" SHPK

Përgjigjie në pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE "Rexha"Shpk,se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesën mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të parashtruar në dosje të tenderit ku është kërkuar qarkullimi financiar për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 10,000,000.00 € (në rast konzorciumi lideri duhet ti plotësoj 60 % të kërkesës),që sipas OE ankues dëshmitë e ofruara e përmbushin vlerën e kërkuar,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Ky pretendim është trajtuar edhe në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020 në të cilin është rekomanduar që AK të kërkoj sqarime lidhur me qarkullimin financiar.
OE ankues "Rexha"Shpk ka dorëzuar deklaratën e qarkullimit financiar të ATK-së për vitin 2017 në vlerë prej 1,764,217.31 €,deklaratën e ATK-së për vitin 2018 në vlerë prej 1,036,771.63 ,ndërsa për vitin 2019 ka dorëzuar një letër konfirimim të bankës Raiffesien Bank sipas të cilës qarkullimi i OE "Rexha" Shpk për vitin 2019 ka qenë 2,623,087.23 €.Gjithashtu ka dorëzuar edhe një konfirmim të bankës TEB sipas të cilës ka pasur një qarkullim 1,037,438.00 €.
Eksperti shqyrtues konstaton se dëshmitë e ofruara nga OE ankues bazuar edhe në kërkesën për sqarime nga AK e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigjie në pretendimin 2.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE "Rexha"Shpk, se AK ka eleminuar ofertën e tyre me arsyetimin se në paramasë të objektit 3,pozicioni 9.1 është përsëritur dy here,eksperti shqyrtes sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit ky ndryshim duhet të trajtohet si gabim aritmetik që nuk kalon vlerën prej 2% të totalit të ofertës.
Vlen të theksohet se OE ankues në njërin pozicion ka paraqitur sasitë që i ka parapare AK-ja,ndërsa në pozicionin vijues ka paraqitur një sasi të gabuar dhe AK është dashur të kërkoj sqarim apo edhe te mos kërkohet fare sqarim,por vetëm të zbritet pozicioni me gabime dhe për këtë të njoftohet tenderuesi.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigjie në pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin e OE "Rexha"Shpk, se oferta e tyre është eleminuar me arsyetimin se nuk ka prezentuar dëshmi të mjatueshme se ka përfunduar kontrata të ngjashme siç është kërkuar në dosje të tenderit,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit AK konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, duhet të i sqaroj kontratat e OE ankues se a e plotësojnë

këtë kërkesë të AK-së.

Me datë 25.09.2020.AK përmes letrës standarde për sqarimin e tenderit nga OE "Rexha"Shpk ka kërkuar sqarime lidhur me atë se në çka bazon pretendimin e tyre për eleminim pa të drejtë lidhur me referencat të cilat janë trajtuar nga AK sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

OE ankues"Rexha" Shpk në përgjigjen e tij ka dorëzuar një listë të kontratave të realizuara së bashku me referencat për realizimin e këtyre kontratave që tejkalojnë vlerën e kërkuar prej 4,500,000.00 €

Në pyetjene një OE drejtuar AK-së për sqarime ""Pasi qe edhe renovimet e objekteve hyjnë ne kategorinë e ndërtimit te larte, atëherë a mund te na tregoni se a njihen si referenca eksperienca e punës ne renovimin e objekteve te larte?",AK me date 31.01.2020 jep këtë përgjigjie/sqarim "Nuk pranohen eksperienca e punës së renovimeve, por pranohen referencat e ndërtimeve te larta – ndërtim i ri (sipas përkufizimit te nenit 3 paragrafi 1.10 te ligjit për nderim NR.04 L-110).

Eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm pasi që Autoriteti Kontraktues është dashur të respektoj sqarimin e dhëne me datën 31.01.2020,sipas të cilit ka sqaruar se pranohen referencat për ndërtime të reja sipas nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-110.Ky nen nuk përcakton ndërtime të larta apo të ulëta por përcakton si vijon:Ndërtimi i ri është ndërtimi që kryhet në një parcele toke ku nuk ka ndërtim ose e zevendson plotësisht ndërtimin ekzistues.Bazuar në këtë OE-ik "Rexha" Shpk është dashur ti pranohen referencat e ofruara si vijon:"Ndërtimi i objektit të shkollës në Arbëri –faza e dytë","Ndërtimi i Bulevardit mbi Kurriz," ,"Ndërtimi i parkut në lagjen Arbëria" , " Sanimi dyshemese urbane në sheshin Adem Jashari" dhe shumë referenca tjera që paraqesin ndërtim të ri sipas Ligjit nr.04/L-110.Pra në këtë mënyrë AK duke mos respektuar sqarimin e vet e ka trajtuar pa të drejtë këtë tenderues si të pa përgjegjshëm.Ky trajtim është edhe më i pa kuptueshëm për faktin se në aktivitetin e AK-së janë të përfshira të gjitha llojet e punimeve që janë të përfshira edhe në kontratat e ofruara nga ky tenderues.OE ankues ka dëshmuar shumë kontrata të projekteve investive/kapitale që njihen si kontrata pune që kanë të bëjnë me ndërtim të ri dhe pothuaj të gjitha këto kontrata përmbajnë lloje/pozicione të punimeve që janë paraparë të kryhen në këtë aktivitet të prokurimit,andaj për ekspertin shqyrtues të gjitha këto kontrata dhe referenca duhet të pranohen nga AK. Konsideroj që pretendimi i OE ankues është i bazuar dhe dëshmitë e ofruara nga OE ankues për kontrata dhe referenca e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit.

Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigjie në pretendimin 4.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Rexha"Shpk,se autoriteti kontraktues ka pranuar referencën e OE të rekomanduar për kontratë lidhur me projektin "Ndërtimi i spitalit pediatrik dhe Kirurgjisë Pediatrike, QKU" edhe pse kjo referencë nuk është nga AK shtetror (QKUK) por është nga një OE privat,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.388-390/20.citoj një pjesë të vendimit," Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se projektin në fjalë, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka të kontraktuar nga QKUK por ka të kontraktuar nga një kompani private.

Shprehja apo përkufizimi "Autoritet kontraktues" nuk nënkupton vetëm autoritetet publike apo shtetërore. Sipas nenit 4 pika 1.14 të LPP-së Autoritet kontraktues është edhe kompania private.Prandaj çdo projekt i kryer nga një OE me një kompani private për të cilin merr edhe referencën e njëjta referencë është e pranueshme sipas ligjit të prokurimit.Edhe në rastin konkret referenca e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë për projektin e kryer në ndërtimin e spitalit në fjalë është e pranueshme dhe si e tillë e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Në kuptim të kësaj që u sqarua, ky pretendim ankimor është i pa bazuar".

Eksperti shqyrtues sqaron se ka dhënë një përgjigjie ndaj këtij pretendimi në një kontest tjetër të parashtruar nga OE "Pe-vla-ku" citoj," Sa i,përket pretendimit të OE ankues se referenca e lëshuar nga "Mabetex Group" për OE e rekomanduar për kontratë për punët e kryera në Spitalin Pediatrik dhe Kirurgjise Pediatrike në QKUK nuk është cekuar vlera e çmimit të ndërtimit të projektit,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim ështe i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave ka prezentuar që ky projekt deri me 31.12.2019 është realizuar në shumën prej 6,649,980.28 €,ndërsa pjesa e mbetur është në proces.OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar kontrate me "Mabetex Group" që mund të dëshmohej pjesëmarrja e OE "Fidola" në këtë projekt.Gjithashtu nuk ka të bashkangjitur ndonjë dëshmi të realizimit të punimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues, në këtë rast QKUK -së,sepse ky projekt akoma nuk është i përfunduar.
AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë sqarime/dëshmi shtesë për kontratën me "Mabetex Group"apo edhe ndonjë dëshmi të AK,"QKUK" lidhur me realizimin e punimeve në këtë projekt"

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigjie në pretendimin 5.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë çertifikatat për ISO STANDARDE nuk i i ka ofruar të noterizuara siç është kërkuar në dosje të tenderit,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 sipas të cilit është kërkuar që AK gjatë rivlerësimit të kërkoj konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së informata shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë më saktësisht çertifikatat ashtu siç ka qenë kërkesë e vet AK-së.
Konform vendimit të OSHP-së,AK me datë 25.09.2020 përmes "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit" ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzoj çertifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit.
Me datë 28.09.2020 OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar çertifikatat e noterizuara të cilat janë noterizuar me datë 20.04.2020 (pas datës së dorëzimit të tenderëve).

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigjie në pretendimin 6.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka shpërblyer me kontratë OE i cili nuk ka dorëzuar dëshmitë për pajisjet siç është kërkuar në dosje të tenderit,konkretisht nuk ka dorëzuar listën e pajisjeve dhe dëshminë për

vinç dhe sipas OE ankues kjo ofertë duhej të shpallej e papërgjegjshme.eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar pasi që tenderuesi i rekomanduar nga AK-ja nuk ka dorëzuar listë të pajisjeve,por vetëm dëshmi për disa pajisje dhe nuk ka dorëzuar dëshmi për pajisjen vinç.Pasi që për këtë pajisje nuk është ofruar asnjë dëshmi,AK-ja ka kërkuar plotësim për këtë pajisje e cila është ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë.AK konform nenit 72 të LPP-së dhe nenit 39.8 të RRUOPP-së duhet të ketë kujdes për sqarimet apo dokumentet që kërkon sepse kjo pajisje nuk ka qenë në listën e pajisjeve.

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigjie në pretendimin 7.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se Inxhinieri i Elektroteknikës-drejtimi energjetikë i prezentuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse inxhinieri është i diplomuar me datë 08.12.2015 dhe nuk plotëson përvojen prej 5 vitesh siç është kërkuar në dosje të tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhët të ofrojnë dëshmi për inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku 2 kontrata të natyres së ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me CV, Diplomë, Kontratë të punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt,referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).

Eksperti shqyrtues sqaron se fillimisht OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një diplomë të z.Behar Zeqiri, i dipl në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 23.11.2015 si Master i shkencave të Inxhinierisë elektrike,që bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit nuk e plotëson përvojen prej 5 vitesh.
Pas kërkesës së AK-së për sqarim OE i rekomanduar ka dorëzuar një tjetër diplomë për z.Behar Zeqiri, i dipl. në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 22.03.2012 si Bachelor i shkencave të Inxhinierisë elektrike, qe sipas ekspertit shqyrtues kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë inxhinier i diplomuar i elektroteknikës dhe sipas kësaj dëshmie z.Behar Zeqiri është bachelor dhe nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.
Në vendimin e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE ankues "Rexha"Shpk ky pretendim është trajtuar si devijim i vogël,që për ekspertin shqyrtues AK nuk ka dhënë asnje argument se çka nënkupton me devijim të vogël kur kërkesa e AK-së ka qenë decidive inxhinieri i diplomuar i elektroteknikës duhet të ketë 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigjie në pretendimin 8.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar deklaratat për listën e punëtorëve të punësuar konform dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të ketë mesataren e punëtorëve të punësuar minimum 100 punëtor për vitin 2017,2018 dhe 2019,eksperti shqyrtues sqaron se

konzorciumi "OE "Fidola" & "Nartel Exin" Shpk ka dorëzuar listat për të dy anëtarët e konzorciumit.OE "Fidola" ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së për tri vitet,ndërsa anëtari tjetër i konzorciumit"Nartel Exin"Shpk ka dorëzuar deklaratat e listave të punëtorëve të vulosura për tri vitet dhe sipas ekspertit shqyrtues deklaratat e dorëzuara për listat e punëtorëve të punësuar janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse në dosje është kërkuar deklaratë dhe nuk është specifikuar që duhet të jetëm vetëm dëshmia e ATK-së.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "PE-VLA-KU" SHPK.

Përgjigjie në pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE "Pe-vla-ku"Shpk, se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve e ka rekomanduar për kontrate përsëri ofertën e grupit të OE"Fidola" & "Nartel Exin"Shpk edhe pse marrëveshja e konzorciumit e dorëzuar nga grupi i OE nuk është e kompletuar dhe mungojnë të dhënat e tenderit,si dhe deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit "Nartel Exin"Shpk është pa datë, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se marrëveshja e konzorciumit të grupit të OE "Fidola" & "Nartel Exin"Shpk është konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe në fund të marrëveshjes të dy anëtarët e konzorciumit kanë dorëzuar autorizimet e nënshkruara dhe të vulosura ku është specifikuar edhe nr i prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit.
Sa i përket pretendimit të OE ankues se deklarata nën betim e anëtarit të konzorciumit "Nartel Exin"Shpk është pa datë,për ekspertin shqyrtues ky pretendim është i paqendrueshëm sepse deklarata nën betim e dorëzuar nga anëtari i konzorciumit "Nartel Exin"Shpk është e vulosur dhe e nënshkruar dhe i drejtohet Autoritetit Kontraktues"Komuna e Prishtinës" dhe mungesa e datës nuk paraqet ndonje shkelje domëthënese.

Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se OE i rekomanduar nuk ka dorëzuar deklarate të specifikacioneve teknike konform nenit 28 të LPP-së,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është i paqëndrueshëm sepse në dosje të tenderit nuk është kërkuar deklarata e specifikacioneve teknike.

Përgjigjie në pretendimin 2.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të gjitha çertifikatat ISO siç janë kërkuar në dosje të tenderit,dhe sipas OE ankues edhe pas kërkesës për sqarim nga AK,OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar çertifikatat OHSAS 18001 2007,ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012,eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar edhe në vendimin e panelit

PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020.
Konform vendimit të OSHP-së.AK me datë 25.09.2020 përmes "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit" ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzoj çertifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit.
Me datë 28.09.2020 OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar çertifikatat e noterizuara të cilat janë noterizuar me datë 20.04.2020 (pas dorëzimit të tenderëve).
Sa i përket pretendimit të OE ankues se mungojnë çertifikatat OHSAS 18001 2007,ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012,eksperti shqyrtues sqaron se dy çertifikatat ISO 27001 2013 dhe PAS 99 2012 janë larguar si kërkesa të dosjes së tenderit në "NJOFTIM PËR INFORMATA SHTESË ose PËRMIRËSIM I GABIMIT",ndërsa për çertifikatën OHSAS 18001 2007 OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çertifikatën ISO 45001-20018 më të avancuar e cila është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20.

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigjie në pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën e gjendjes ekonomike dhe financiare të dosjes së tenderit ku është kërkuar që qarkullimi financiar për tri vitet e fundit të jetë jo më pak se 10,000,000.00 € (në rast konzorciumi lideri duhet ti plotësoj 60 % të kërkesës), eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
OE i rekomanduar për kontratë,konkretisht lideri i konzorciumit "Fidola " ka dorëzuar deklaratën e qarkullimit financiar të ATK-së për vitin 2017 në vlerë prej 575,240.56 €,deklaratën e ATK-së për vitin 2018 në vlerë prej 1,287,630.13 €,ndërsa për vitin 2019 ka dorëzuar një deklaratë të bankës Raiffesien Bank sipas të cilës qarkullimi i OE "Fidola"për vitin 2019 ka qenë 4,417,286.86 €.Ndërsa për anëtarin tjetër të konzerciumit "Nartel Exin"Shpk ka dorëzuar deklaratën e ATK-së për vitin 2017 në vlerë 1,841,999.70 €,për vitin 2018 vlerën prej 1,647,393.61 €,ndërsa për vitin 2019 kanë dorëzuar një pasqyrë të të ardhurave të "Nartel Exin"Shpk me shumën hyrëse për vitin 2019 në vlerë prej 1,456,295.74 €.

Eksperti shqyrtues konstaton se dëshmitë e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë bazuar edhe në kërkesën për sqarime nga ana e AK-së e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigjie në pretendimin 4.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se Inxhinieri i Makinerisë i prezentuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është konform dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhet të ofrojnë një inxhinier të diplomuar të makinerisë (termoenergjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet te ketë udhëhequr se paku 2 kontrata të natyrës se ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me diplomë, kontrata e punës me punëdhënsin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt,referenca per Inxhinier i dip. i makinerise (termoenergjetike).

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar diplomën e z. Aziz Llugiqi i diplomuar në Fakultetin Teknik të Prishtinës në vitin 1980.
Eksperti shqyrtues sqaron se dokumentet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë e plotësojnë këtë kërkesë të dosejs së tenderit sepse Fakulteti Teknik në kohën kur ka diplomuar z Aziz Llugiqi nuk ka qenë i ndarë në drejtime,por drejtimi i Makinerisë i ka përfshirë edhe drejtimet tjera.

Sa i përket pretendimit se OE të rekomanduar për kontratë i mungon kontrata për inxhinierin e hidroteknikës,eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar diplomen dhe kontratën e punës për inxhinierin e Hidroteknikës z.Bujar Gashi,andaj ky pretendim i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigjie në pretendimin 5.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme duke potencuar disa referenca të cilat sipas OE ankues nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e kontratave të realizuara konform aneksit 7 të dosjes së tenderit.
Sa i përket pretendimit të OE ankues se referenca e lëshuar nga "Mabetex Group" për OE e rekomanduar për kontratë për punët e kryera në Spitalin Pediatrik dhe Kirurgjise Pediatrike në QKUK nuk është cekuar vlera e çmimit të ndërtimit të projektit.eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim ështe i bazuar sepse OE i rekomanduar për kontratë në listën e kontratave ka prezentuar që ky projekt deri me 31.12.2019 është realizuar në shumën prej 6,649,980.28 €,ndërsa pjesa e mbetur është në proces.OE i rekomanduar për kontrate nuk ka ofruar kontratë me "Mabetex Group" që mund të dëshmohej pjesëmarrja e OE "Fidola" në këtë projekt.Gjithashtu nuk ka të bashkangjitur ndonjë dëshmi të realizimit të punimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues, në këtë rast QKUK -së,spese ky projekt akoma nuk është i përfunduar.
AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë sqarime/dëshmi shtesë për kontratën me "Mabetex Group" apo edhe ndonjë dëshmi të AK-së "QKUK" lidhur me realizimin e punimeve në këtë projekt.
Gjithashtu edhe pretendimi tjetër së referenca e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë për "Ndërtimin e fabrikës së gazit mjekësor dhe industrial" e lëshuar nga OE "Medica" nuk ka të cekur vlerën e projektit për ekspertin shqyrtues është i pranueshëm sepse referenca nuk ka të cekur vlerën e projektit.Meqënse nuk ka vlerë të cekur në referencë,AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj sqarime/dëshmi nga OE i rekomanduar që të dorëzoj kontratën me OE 'Medica".
Lidhur me referencën e lëshuar nga Kompania Dugagjini për OE të rekomanduar për kontratë për objektin afaristo banimor ,blloku A1,Lakërishte, që sipas OE ankues në këtë reference thuhet se punimet kanë filluar në nëntor 2015 dhe kanë përfunduar në dhjetor 2018,ndërsa referenca është lëshuar në prill të vitit 2017,eksperti shqyrtues sqaron se në reference thuhet se punët do të përfundojnë në dhjetor 2018 bazuar në kontratë dhe jo kanë përfunduar.Gjithsesi AK është dashur të kërkoj nga OE i rekomanduar për kontratë,kontratën me OE "Dugagjini Kompani" dhe ndonjë dëshmi të realizimit të këtij projekti siç është raporti i përfundimit i çertifikuar nga dhënsi i lejës së ndërtimit,në këtë rast Kuvendi Komunal.
Gjithashtu edhe pretendimi tjetër për referencen lidhur me objektin afaristo banimor Trade Center Prishtina, që sipas OE ankues OE i rekomanduar për kontratë i ka lëshuar reference vetë vetes, sepse në këtë projekt

është në konzorcium me "Agro Trade", eksperti shqyrtues në bazë të dëshmisë nuk mund ta konstatoj që ka qenë konzorcium por AK ka mundur të kërkoj kontratën nga OE "Fidola" me "Agro Trade".Gjithashtu edhe për këtë projekt nuk ka ndonjë raport të çertifikimit të punimeve për këtë objekt banesor nga dhënsi i lejës së ndërtimit,në këtë rast Kuvendi Komunal.Edhe në këtë reference nuk ka vlerë të cekur se sa është vlera e përfunduar e punimeve.

Eksperti shqyrtues konstaton se referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar që lideri duhet ti plotësoj 60% të referencave për kontratat e realizuara (4,500,000.00 €),sepse referencat nuk përmbajnë vlera të realizimit të punimeve.Për shkak se shumica e referencave janë më OE privat,AK konform nenit 72 të LPP-së është dashur të kërkoj sqarime/dëshmi shtesë lidhur me kontratat dhe referencat e dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigjie në pretendimin 6.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar listën e makinerive siç është kërkuar në dosje të tenderit,eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi lidhur me makineritë është pak a shumë i ngjashem dhe është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje të tenderit për këtë pikë nuk ka qenë decidivisht që pajisjet, respektivisht kamionët duhet të janë të regjistruar. Por për pajisje janë kërkuar dëshmi si deklarata unike doganore ose kontrata për faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar si dëshmi librezat e kamionëve si dëshmi që i posedojnë këta kamion. Regjistrimi i automjetit mundet të bëhet varësisht prej nevojave të kompanisë. I duhet një kamion i tillë për transport apo nuk i duhet. E rëndësishëm për këtë pikë të dosjes së tenderit është që OE ti posedojnë këto pajisje,prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar".

Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Përgjigjie në pretendimin 7.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar deklaratat për listën e punëtorëve të punësuar konform dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të ketë mesataren e punëtorëve të punësuar minimum 100 punëtor për vitin 2017,2018 dhe 2019,eksperti shqyrtues sqaron se konzorciumi "OE "Fidola" & "Nartel Exin"Shpk ka dorëzuar listat për të dy anëtarët e konzorciumit.OE "Fidola" ka dorëzuar listën e punëtorëve të ATK-së për tri vitet,ndërsa anëtari tjetër i konzorciumit"Nartel Exin"Shpk ka dorëzuar deklaratat e listave të punëtorëve të vulosura për tri vitet dhe sipas ekspertit shqyrtues

deklaratat e dorëzuara për listat e punëtorëve të punësuar janë konform kërkesës së dosjes së tenderit sepse në dosje është kërkuar deklaratë dhe nuk është specifikuar që duhet të jetëm vetëm nga dëshmia e ATK-së.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigjie në pretendimin 8.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar marrëveshjet për gurëthyes dhe beton të cilat nuk janë të nënshkruara dhe vulosura,eksperti shqyrtues se ky pretendim është pranuar edhe nga AK në vendimin e tyre ndaj kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga OE ankues.
Eksperti shqyrtues sqaron se të dy marrvëshjet për gurëthyes dhe beton të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë janë të nënshkruara dhe vulosura nga ana e furnitorit ku janë të bashkangjitura edhe "Lejet për aktivitete të veqanta "(Liçencat) për të dy furnitorët,ndërsa me kërkesë të AK-së, marrëveshjet janë të nënshkruara edhe nga blerësi në këtë rast nga OE "Fidola"

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "RAF II" SHPK

Përgjigjie në pretendimin 1.

Sa i përket pretendimit të OE ankues"Raf II"Shpk,se Inxhinieri i Elektroteknikës-drejtimi energjetikë i prezentuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit sepse inxhinieri është i diplomuar me datë 08.10.2015 dhe nuk plotëson përvojen prej 5 vitesh siç është kërkuar në dosje të tenderit,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.
Në dosje të tenderit është kërkuar që OE duhët të ofrojnë dëshmi për inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (drejtimi energjetike) me 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Duhet të ketë udhëhequr së paku 2 kontrata të natyres së ngjashme (ndërtim i larte) e dëshmuar me CV, Diplomë, Kontratë të punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt,referenca per Inxhinier i dip. i elektroteknikes (drejtimi energjetike).

Eksperti shqyrtues sqaron se fillimisht OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një diplomë të z.Behar Zeqiri, i dipl në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 23.11.2015 si Master i shkencave të Inxhinierisë elektrike,që bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit nuk e plotëson përvojen prej 5 vitesh.
Pas kërkesës së AK-së për sqarim, OE i rekomanduar ka dorëzuar një tjetër diplomë për z.Behar Zeqiri i dipl në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike me datë 22.03.2012 si Bachelor i shkencave të Inxhinierisë elektrike, qe sipas ekspertit shqyrtues kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë inxhinier i diplomuar i elektroteknikës dhe sipas kësaj dëshmie z.Behar Zeqiri është bachelor dhe nuk e plotëson kërkesën e dosjes së

tenderit.
Në vendimin e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga një OE, ky pretendim është trajtuar si devijim i vogël,që për ekspertin shqyrtues AK nuk ka dhënë asnjë argument se çka nënkupton me devijim të vogël kur kërkesa e AK-së ka qenë decidive inxhinieri i diplomuar i elektroteknikës duhet të ketë 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

Pretendimi ankimor është i bazuar.

Përgjigjie në pretendimin 2.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar të gjitha çertifikatat ISO siç janë kërkuar në dosje të tenderit dhe sipas OE ankues,OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar çertifikatat OHSAS 18001 2007,ISO 27001 2013,eksperti shqyrtes sqaron se ky pretendim është trajtuar edhe ne vendimin e panelit PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020.
Konform vendimit të OSHP-së,AK me datë 25.09.2020 përmes "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit" ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë që ti dorëzoj çertifikatat e noterizuara konform kërkesës së dosjes së tenderit.
Me datë 28.09.2020 OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar çertifikatat e noterizuara të cilat janë noterizuar me datë 20.04.2020 (pas datës së dorëzimit të tenderit).
Sa i përket pretendimit të OE ankues se mungojnë çertifikatat OHSAS 18001 2007 dhe ISO 27001 2013,eksperti shqyrtues sqaron se çertifikata ISO 27001 2013 është larguar si kërkesë e dosjes së tenderit në "NJOFTIM PËR INFORMATA SHTESË ose PËRMIRËSIM I GABIMIT",ndërsa për çertifikatën OHSAS 18001 2007 OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çertifikatën ISO 45001-20018 më të avancuar e cila është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.388-390/20.

Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigjie në pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar listën e makinerive siç është kërkuar në dosje të tenderit,eksperti shqyrtues se pretendimi lidhur me makineritë është pak a shumë i ngjashem dhe është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.388-390/20,citoj një pjesë të vendimit "Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesa në dosje të tenderit për këtë pikë nuk ka qenë decidivisht që pajisjet, respektivisht kamionët duhet të janë të regjistruar. Por për pajisje janë kërkuar dëshmi si deklarata unike doganore ose kontrata për faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar si dëshmi librezat e kamionëve si dëshmi që i posedojnë këta kamion. Regjistrimi i automjetit mundet të bëhet varësisht prej nevojave të kompanisë. I duhet një kamion i tillë për transport apo nuk i duhet. E rëndësishëm për këtë pikë të dosjes së tenderit është që OE ti posedojnë këto pajisje,prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar".

Pretendimi ankimor është i pa bazuar

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka rivlerësuar tenderët konform dispozitave ligjore dhe kërkesave të dosjes së tenderit si dhe vendimit të OSHP-së, PSH.nr.388-390/20 të datës 12.08.2020,andaj rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim dhe gjatë rivlerësimit AK të respektoj kërkesat e parashtruara në dosje të tenderit dhe vendimin e OSHP-së,PSH.nr.388-390/20 duke pasur parasysh edhe nenin 1 të LPP-së,pasi që dihet që qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë dhe nenin 6 të LPP-së,ku të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të **aprovohen si pjesërisht të bazuara**,të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – "KK PRISHTINË"
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues - "REXHA"SHPK
- OE ankues - "PE-VLA-KU"SHPK
- OE ankues - "RAF II"SHPK